



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 120, datë 06.03.2024

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 57, DATË 07.02.2024 “PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 DHE NR. 247 DATË 24.05.2023 DHE GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 235, 236, 237 DHE 238 DATË 24.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pika 1 dhe nenin 86, shkronja “ë”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, vendimin nr. 4, datë 14.02.2024 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira

të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nënpika 22, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Ridvan Hado

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidatis z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR